



## TË STUDIARIT NË PRIZREN

Jeta në kampus është mjaft aktive me organizime sportive, rekreative dhe argëtuese të organizuara nga këshilli i studentëve. Mund të studioni me kolegë në Bibliotekën e qytetit që gjendet në qendër të Prizrenit, apo krahas lumit "Lumbardh".

Pranë kampusit universitar gjendet edhe parku më i madh i qytetit. Në Prizren gjendet edhe pjesa më e rëndësishme e qytetit, "Shadervani" i cili gjithmonë gumëzhin me aktivitete të ndryshme.

Jo vetëm për të përmendur një ndër asetet më të vlefshme të Universitetit të Prizrenit, por pa dyshim Prizreni është qyteti më i bukur dhe më me rëndësi jo vetëm në Kosovë, por në tërë trojet shqiptare.

Galeria e Prizrenit, dyqanet dhe restorantet të ofrojnë komoditet dhe janë argëtuese.



## KONTAKTONI ME NE

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
Adresa: Rruga e Shkronjave, nr. 1 20000  
Prizren, Republika e Kosovës  
[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

Tel: 029 232-140

Email: rektorati@uni-prizren.com

 <https://www.facebook.com/Uni.UkshiHoti/>



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE  
MJEDISIT



**Programet e studimit:**  
- Agrobiznes  
- Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit



## PERSPEKTIVA E KARRIERËS

Pas përfundimit të studimeve, të diplomuarit në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit do të kenë kualifikimin e nevojshëm për të punuar në shumë fusha si:

- Menaxhimin e ndërmarrjeve agropërpunuese.
- Menaxhimin e ndërmarrjeve që merren me tregtimin e agroinputeve.
- Menaxhimin e fermave bujqësore dhe blegtorale të orientuara nga tregu.
- Në banka dhe institucione financiare
- Institucione publike lokale dhe qendrore
- Organizata vendore dhe ndërkombëtare
- Ndërmarrjet e shërbimeve pyjore publike
- Organizatat për menaxhimin e kafshëve të egra dhe mbrojtjen e natyrës
- Organizata qeveritare dhe joqeveritare që merren me mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit.

Studimet në këto dy programe janë të nivelit BSc (3 vjeçare), i organizuar në 6 semestra nga 30 ECTS, secili prej tyre, gjithsejt 180 ECTS.



## NJOHURI SHKENCORE DHE EKSPERTIZA PRAKTIKE

Çfarë do të ishte hulumtimi pa përvojë praktike? Çfarë do të ishte përvoja praktike pa njohuri të fituara nga hulumtimi? Pikërisht dy programet tona themelore e bëjnë lidhjen në mes pjesës teorike dhe praktike. Metoda “të mësuarit duke parë dhe duke e praktikuar” i përgatit studentët dhe i aftëson për tregun e punës.

Objekti i ri i Fakultetit ofron të gjitha kushtet e të bërit hulumtime, ku janë të pajisura me laboratore moderne të përshtatura për dy programet e Fakultetit.

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren ka marrëveshje për bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Përfitues të kësaj marrëveshje janë studentët e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit të UPZ-së, të cilët do të kenë mundësi të kryejnë praktikën në kuadër të studimeve të tyre.

Universiteti “Ukshin Hoti”, në Prizren është pjese e programit Erasmus +, ku ofrohen shumë mundësi të shkëmbimit të stafit dhe studentëve me shumë vende anëtare të BE-së.



Universiteti Publik i Prizrenit “Ukshin Hoti”, në Prizren (UPZ) ka nisur punën në vitin 2010. Selia e Universitetit është në Prizren, njëri nga qytetet më të lashta të Kosovës. UPZ është Universiteti i dytë publik në Kosovë. Në vitin 2010 numri i studentëve ishte afër 1,700, ndërsa tani, numri i studentëve është rreth 17,000.

Misioni themelor i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në kuadër të UPZ-së, është ofrimi i niveleve të edukimit universitar dhe hulumtimit shkencor që ndërlidhen me Shkencat e natyrës së gjallë, Mjedisit dhe Agrobiznesit.

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit ofron studimin në:

- Programet Akademike:
- Agrobiznes (Bachelor)
  - Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit (Bachelor)

Programet e reja studimore Agrobiznes si dhe Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit janë unike në Kosovë dhe mund të studiohen vetëm në UPZ.

Këto programe do të kenë ndikim direkt dhe indirekt në rritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik me bazë shkencore të regjionit të Prizrenit dhe vendit në përgjithësi.